

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 30.04.2026, në orën 11:00, në sallën e këshillit bashkiak, në Pallatin e Kulturës Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të muajit Prill 2026, të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës.

-Ndue Luli: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për pjesëmarrjen. Mbledhjen e deklaroj të hapur.

Sot kemi mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë për muajin Prill 2026. Mbledhja zhvillohet me këtë rend dite:

1. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Mars 2026”
2. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare për përmbytje në banesë” (10 raste)
3. Projekt-Vendim “Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit të vitit 2026”
4. Projekt-Vendim “Për miratimin e hartës së plazheve të lejuara, vendbazimeve ujore dhe zonave të aktiviteteve rekreative ujore në bregdetin Rana e Hedhun, Shëngjin, Kune, Vain dhe Tale, për sezonin turistik veror 2026, përcaktimin e kriterëve e procedurave për administrimin e vendbazimeve ujore dhe aktiviteteve rekreative ujore si dhe tarifave maksimale për ofrimin e shërbimit”
5. Projekt-Vendim “Për vënien në dispozicion të ndërmarrjes “LEZHA INVEST shpk” të stacioneve publike të plazhit në Bashkinë e Lezhës dhe përcaktimin e tarifave maksimale për ofrimin e shërbimit në plazhet publike në administrim të Lezha Invest”
6. Projekt-Vendim “Për miratimin e plan-masave për parandalimin, menaxhimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota si dhe krijimin e njësisë vullnetare të shuarjes së zjarreve për vitin 2026”
7. Projekt-Vendim “Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK”
8. Projekt-Vendim “Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore”
9. Projekt-Vendim “Për miratimin e akordimit të fondit për shpërblimin e sportistit kampion kombëtar”
10. Projekt-Vendim “Për ndryshimin e emërimit të degëzimit të Rugës së Shelbuemit, që mban të njëjtin emër dhe të marrë emrin “Hil Simon Hila”, në qytetin Lezhë”
11. Projekt-Vendim “Për miratimin e zgjedhjes së anëtarëve të kryesive dhe të kryetarëve të tre fshatrave në Bashkinë Lezhë”
12. Të ndryshme

Kush është dakord me rendin e ditës, ju lutem? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 26 vota Pro. Faleminderit.

Fillojmë me pikën e parë, Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Mars 2026”.

Ka kush ndonjë mendim? Nuk ka. Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 26 vota Pro. Faleminderit.

Pika 2, Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare për përmbytje në banesë” Janë 10 raste. Në projektvendim i keni rastet. Kush ka ndonjë problem, ndonjë diskutim? Po, znj. Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Së pari e vlerësoj këtë projektvendim. Duke lexuar emrat e familjeve, konstatoj se një pjesë e tyre, me të drejtë, janë banorë të pallatit nr. 16 të lagjes Skënderbeg dhe unë shfrytëzoj këtë hapësirë për ta risjellë edhe njëherë në vëmendje. Kam parashtruar dhe në mbledhjen e kaluar, banorët e pallatit 16 e kanë të domosdoshme të kenë nga Bashkia e Lezhës një zgjidhje sa i përket strehimit. Pallati i tyre është konstatuar i pabanueshëm në vitin 2008, është dëmtuar akoma më shumë pas tërmetit të vitit 2019 dhe aktualisht që flasim është e domosdoshme shembja e tij, pasi përbën rrezik për këta banorë, por edhe kalimtarët e zonës. Unë mendoj dhe shpreh, duke marrë fjalën edhe të banorëve të këtij pallati, që Bashkia e Lezhës duhet të shohë mundësinë për t'i përfshirë në skemën e bonusit të qirasë. Gjithashtu duhet të shohë mundësinë e një projekti ndërtimi mbi atë truall, ku këto familje të jenë pjesë dhe të marrin pjesën e tyre takuese të apartamenteve. Pse jo, Bashkia të shikojë edhe mundësinë e ndonjë projekti të mundshëm social. Gjithashtu banorët janë të hapur për bisedime me Bashkinë, me qëllim që nga ana e këtij institucioni të ketë lehtësi sa i përket procedurave dhe për leje ndërtimi në rast të një iniciative të përbashkët nga ana e tyre. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Mendim tjetër? Zoti nënkryetar.

-Fatjon Zefi: Po presim vlerësimin përfundimtar të Institutit të Ndërtimit për pallatin, pasi ka më shumë se 15 vite që është bërë ai vlerësim. Ndërsa për këtë të programeve sociale, mendoj që pas ndërtimit nga Enti i Banesave të pallateve mund të orientohemi që edhe këto të jenë pjesë e këtij strehimi.

-Ndue Luli: Faleminderit. Mendim tjetër? Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 26 vota Pro. Faleminderit.

Pika 3, Projekt-Vendim “Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit të vitit 2026”. Mendime, diskutime në lidhje me projektvendimin? Ka? Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 26 vota Pro. Faleminderit.

-Erdhi këshilltari Ervin Coli.

-Ndue Luli: Vazhdojmë me pikën 4, Projekt-Vendim “Për miratimin e hartës së plazheve të lejuara, vendbazimeve ujore dhe zonave të aktivitetëve rekreative ujore në bregdetin Rana e Hedhun, Shëngjin, Kune, Vain dhe Tale, për sezonin turistik veror 2026, përcaktimin e kriterëve e procedurave për administrimin e vendbazimeve ujore dhe aktivitetëve rekreative ujore si dhe tarifave maksimale për ofrimin e shërbimit”.

Në lidhje me projektvendimin, kush e do fjalën? Znj. Marku.

-Alfrida Marku: Atëherë në këtë projektvendim është sqaruar procedura se si subjektet duhet të aplikojnë për të marrë të drejtën e përdorimit apo ushtrimit të aktivitetit në vendbazimet apo hapësirat për aktivitete rekreative ujore. Unë do doja të dija se cila është distanca e detyrueshme nga bregu e vendbazimeve, të cilat pastaj do të miratohen nga Bashkia.

-Ndue Luli: Drejtori i urbanistikës e ka fjalën.

-Flamur Kuçi: Përshëndetje. Nuk ka një standard teknik. Vendbazimet duhet të dalin deri në breg, sepse aty zbresin qytetarët. Vendbazimet janë korridore sigurie, pra që të krijojnë sa më mundësi që të hyjnë e të dalin mjetet e lundrimit, kuptohet të një kapaciteti të caktuar, se jo çdo lloj mjeti të hyjë aty dhe të krijohet korridori i sigurisë me pjesën tjetër të plazhit.

-Alfrida Marku: Po hapësira rekreative, distanca nga bregu i hapësirave për zhurmën?

-Flamur Kuçi: Nuk ka një standard teknik për këtë gjë. Ajo çfarë ia vlen me u theksu këtu, është që projektvendimi shtjellon një procedurë dhe plotëson praktikisht një vakum, një boshllëk që kishte në procedurën për administrimin e këtyre vendbazimeve, sepse deri sot detyrimi jonë ka qenë vetëm t'i vendosim në hartë, por nuk ka pasur një procedurë të mirëfilltë se si duheshin me u administru. Në fakt, në mungesë të kësaj procedure, Bashkia është investuar në rregullimin e një procedure për dhënien, administrimin, inspektimin, mbikëqyrjen e këtyre vendbazimeve, kuptohet në bashkëpunim edhe me institucione të tjera.

-Ndue Luli: Faleminderit. Mendim tjetër?

-Alfrida Marku: Një sqarim, Drejtorja e Urbanistikës, a ka një standard mbi të cilin parashikon të veprojnë në momentin që të miratohen hapësirat në det ku do të ushtrohen aktivitete rekreative? Se në projektvendim thuhet subjektet do të aplikojnë, atëherë do të aplikojnë në njësinë administrative, respektivisht në Shënkoll dhe në Shëngjin. Atëherë përzgjedhja e tyre do të bëhet cili subjekt garanton nivelin më të lartë të sigurisë. Pra a ka një standard minimal të cilin Bashkia e ka të detyrueshëm? Pra një distancë të detyrueshme të këtyre hapësirave?

-Ndue Luli: Fjala për drejtorin.

-Flamur Kuçi: Në fakt nuk mundet me pasë Bashkia, sepse nuk ka një standard të tillë, nuk ka një normativë të tillë sigurie apo distance. Ajo çfarë ne kemi kërku dhe që është e parashikuar në vendimin e Këshillit Bashkiak, është detyrimi që ka operatori, se aktualisht flasim vetëm për detyrimet që kanë përdoruesit, jo ai që e menaxhon vendbazimin apo ai që menaxhon pjesën e lojrave ujore. Ajo çfarë ne jemi investuar në këtë lloj procesi është që i kërkojmë, përgjegjësia është e atij operatori për me na dhënë një plan sigurie. Ai do të ketë në dokumentacionin e tij, do të ketë të parashikuar planin e sigurisë, mjetet që do të përdoren për sigurinë, mjetet e shpëtimit e me radhë, siç është njësoj për plazhet që është vrojtuesi i plazhit, në të njëjtën formë siç stacionet e plazhit e prezantojnë këtë lloj plani operacional Agjencisë së Bregdetit, në të njëjtën formë vendbazimet dhe këto të lojrave ujore do t'i prezantojnë një plan të tillë ku do të jenë të parashikuara masat e sigurisë, do t'i shqyrtojë Bashkia në këtë rast.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Është një problem për t'u parë me kujdes. Caktimi i vendbazimit nuk do të thotë se ne nuk do të ndjekim kushtet në të cilat do ndërtohet vendbazimi. Ka disa standarde të

përcaktuara tashmë. Agjencia e Bregdetit i ka të përcaktuara, por ne vëmë vendet një, dy, tre, pesë dhe ne nuk kemi pse mos t'u lëmë mundësinë njerëzve që ta zhvillojnë, qoftë edhe me lojra ujore, gjë që ne s'e kemi, por gjithë bota e ka, po edhe me këto të tjerat që unë s'i kam shumë qejf, po në fund të fundit nëse plotësojnë të gjithë standardet e vendbazimit, ne po, s'kemi pse i ndalojmë. Por ne nuk japim një vend dhe i themi: "Hajde ti edhe bëj çka të dush aty," por në qoftë se ti nuk krijon kushtet e nevojshme të sigurisë me tapa, me rrugën e kalimit, me vendbazimet, me mënyrën se si shmang të gjithë zonën e plazhit e tjera. Pra nuk diskutohet kjo gjë dhe ne shyqyr Zotit nuk është se kemi pasur ndonjë aksident në këto situata, sepse edhe ato që i kanë bërë deri tashti janë treguar të përgjegjshëm. Pra ka pasur ndonjë rast devijimi, por nuk është fenomen në Shëngjin, as në Tale ky problem. Pra kanë shkuar në thellësi, por në zonat ku kanë qenë zonat e larjes së plazhistëve nuk kemi pasur. Sepse ne e kemi menaxhuar, secili ka bërë punën e vet, është një gjë që implikon të gjitha institucionet, s'jemi vetëm ne që e marrim përsipër këtë. Ne monitorojmë kushtet dhe nëse kushtet janë të realizuara, atëherë ne jemi ok.

-Ndue Luli: Faleminderit. zoti Suta e ka fjalën.

-Marin Suta: Përshëndetje. Unë kam një propozim. Në zonën te Rana së Hedhun, vjet kemi pasur një vendbazim me numër 58 dhe propozoj që ta shohim edhe këtë vit. Ndoshta është bërë një lapsus në hartë.

-Ndue Luli: Atëherë fjalën e ka drejtori në lidhje me propozimin që ka këshilltari.

-Flamur Kuçi: Zotëria ka të drejtë, edhe te Rana e Hedhun, edhe tek kalata e portit që kanë qenë si vendbazime, është një spostim që është gabim i programit. Kështu që do të mundohemi me i korrigju në zbardhje të vendimit.

-Ndue Luli: Atëherë, duke pasur për bazë dhe propozimin e këshilltarit dhe duke bërë edhe ato ndryshime që thotë dhe drejtori i urbanistikës, kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 26 vota Pro. Këshillartja Alfrida Marku votoi Abstenim. Faleminderit.

Kalojmë te pika 5, Projekt-Vendim "Për vënien në dispozicion të ndërmarrjes "LEZHA INVEST shpk" të stacioneve publike të plazhit në Bashkinë e Lezhës dhe përcaktimin e tarifave maksimale për ofrimin e shërbimit në plazhet publike në administrim të Lezha Invest".

Në lidhje me këtë projektvendim?

Fjala për z. kryetar.

-Pjerin Ndreu: Tani, në qasjen e re që kemi ne, me stacionet e plazhit, kemi dy profile sjelljeje. E para është miratimi që bëhet për strukturat hoteliere me koeficientin një dhomë, dy shezllone që vazhdon të jetë. Shumë nga strukturat hoteliere kanë marrë kontrata pesëvjeçare vjet. Zhbëhen kontratat pesëvjeçare që kanë qenë pa struktura hoteliere, pra i vijnë në nivelin zero, çfarë do të thotë që shtohet mundësia e disa hotelerive për akomodim, por shtohet edhe mundësia e hapësirave të lira, qoftë me zero pagesë, qoftë me menaxhimin e Lezha Invest. Pra hyn në lojë Lezha Invest me menaxhimin që ne kemi bërë vjet, por që sivjet do ta perfeksionojmë më shumë. Vjet kemi dalë me fitim, nuk është me humbje. Sivjet mendoj se duhet të vazhdojmë. Ajo që na ka shqetësuar vjet është kjo që strukturat hoteliere, duke marrë stacionet e plazhit me aplikim në Agjencinë e Bregdetit dhe me konfirmim nga ana jonë, kanë shitë shezllone. Destinacioni i marrjes së këtyre shezlloneve është për shërbimet e brendshme që kanë lidhje me klientelën e

vetë hotelit. Nuk kanë lidhje fare me shitjen. Në kohën kur ndodh që një hoteleri nuk i ka kapacitetet e mbushura të dhomës, se e zëmë që një hotel ka 50 dhoma dhe ka të mbushura 40, po e zëmë 10 dhoma që i bie me shezllone, 10 herë 2 janë bosh. Atëherë çfarë ka ndodhur vjet? Hotelëritë i kanë shitur sipas qejfit. EE kanë çuar çmimin deri në 10, 15, 20, kundër me tavanin e çmimit që ne kemi vendosur si Bashki. Sivjet ne do ta disiplinojmë, dhe ne i kemi kërkuar dhe qeverisë që ta disponojë me VKM, që të vejë limit. Njëherë ti nuk e ke si destinacion me e shit, por nëse do e shesësh sepse nuk ke njeri, ti do kesh një limit dhe do shkosh në harmoni me çmimin që ka shteti. Pra, nëse Lezha Invest do e shesë, e zëmë, me 4000 lekë shezllonin, atëherë edhe ti me 4000 lekë do e shesësh shezllonin si hoteleri. Nuk do ta shesësh 10 sipas qejfit tënd. Kam dëgjuar dhe histori të tjera. Unë dje kam qenë me mbi 150 operatorë aty dhe e kam diskutuar. Asnjëri nuk kishte kundërshtim me këtë. Ama kemi bërë një përshtatje tjetër që është krejt logjike. Ma kanë kërkuar dhe e kemi bërë. Dhe ju thashë që destinacioni i marrjes së stacionit për hotelëritë është klientela e hotelit. Nuk është fitimi. Dhe ku fitoj unë? Jo, ti e ke për shërbimin tënd. Ti ia merr në dhomë atij zotërisë lekët. Pra, në çmimin e dhomës i merr edhe lekët e shezllonit, shezlloni jepet free. S'mund ta shesësh si të duash ti se është hapësira publike e Bashkisë ajo, nuk është e atij personalisht. Dhe mbi hapësirën publike të Bashkisë nuk mund të disponohet kush të bëjë çfarë të dojë. Pikërisht ky ka qenë qëllimi që të vëmë kontroll edhe këtë. Por ka pasur nga ata që duke qenë ditë e shtunë, e diel e kanë çuar çmimin 20 mijë lekë.

Ka pasur 4000 lekë të vjetra, ka pasur me 3000 lekë në Tale. Madje në Tale na kanë kërkuar më shumë, sepse dakord me 3000 lekë, por na le mundësinë që të zhvillojmë komplet zonën me 3000 lekë vjetra. Ne sivjet do ta menaxhojmë vetë me Lezha Invest sepse në fund të fundit, gjenerojmë fitime edhe ne dhe nga viti në vit perfeksionojmë skemën edhe të infrastrukturës aty, duke gjeneruar fitime. Pra, kjo është e lidhur. Nga ana tjetër na ka dalë një problem tjetër. Njëri ka cilësi shërbimi të mirë, domethënë të nivelit minimal që ka të bëjë me ato shezllonet e aluminit e me çadra të thjeshta. Disa e kanë me shezllone druri me dyshek, që është cilësi tjetër, më e lartë. Është krejt normale që nuk mund të jenë dy çmime njësoj dhe është shumë e drejtë. Pastaj dikush na ka kërkuar: "Unë kam disa familjarë që duan të rrinë në privatësinë e vet me fëmijë", ato gazibot që janë, janë dakord me pagu më shtrenjtë dhe ne u kemi lënë hapësirë. Pra, është niveli minimal që ka të bëjë me çadrat, që shkon si ka qenë vjet. Është niveli i mesëm që vjen me të gjitha çadrat që vijnë me kushte të tjera, me shezllone druri, me dyshekë që vijnë më shtrenjtë. Por u diskutua dhe dje me operatorët, ky është kufiri maksimal. Ti mund t'i japësh më poshtë, është problemi jot. Për shembull, thotë: "Unë du me e dhënë me 6000." Po jepe. Po sipër kësaj s'e jep dot. Domethënë dhe pra 7000 vjen në Tale, 8000 vjen në Shëngjin me dyshekë, në qoftë se ti krijon infrastrukturë dhe 10 mijë te Rana e Hedhun. Atëherë me gazibot 15, 20, 25. Këto janë luks pastaj. Këto janë kërkesa që unë kam lekë, du me nejt në një strukturë tjetër, ne i japim mundësinë. Pra rankojmë sipas cilësisë dhe kjo është normale që nëse ke cilësinë më të mirë, normalisht që do vësh çmimin më të shtrenjtë. Të gjitha profilet e ofertave ne i kemi në taerren. E kemi me zero, e kemi me tre, e kemi me katër, e kemi me pesë, e kemi me gjashtë, me shtatë, me tetë. Zgjidh dhe merr si e do ti. Pra nuk ka një gjë që i mungon një pushuesi. Do pushuesi mos me pagu asgjë, e ke atje, merr çadrën me vete dhe e ke mundësinë. Janë të gjitha variantet. Pra duke i dhënë ne një kufizim këtyre, ne fillojmë dhe kemi krijuar vjet edhe këto diskutime që unë e kam parë, janë propozime të operatorëve vetë. Dje kur e kemi diskutuar, kanë qenë të gjithë dakord, kanë thënë: "Kjo është zgjidhje." Është zgjidhje që i lë mundësinë atyre, por edhe mos harroni se këtu hyn Lezha Invest në mes. Hyjmë ne. Domethënë duke hyrë Lezha

Invest, nuk bëhet fjalë për hoteleritë se ajo ngelet bosh për shkak të mosklientelës, por Lezha Invest mundet të disponohet me çmime të tjera dhe mund të bëjë ato bashkëpunimet e veta me gjithë strukturat e tjera në terren. Prandaj ka një llogjikë kjo. Është e diskutuar, është e dakordësuar dhe është një gjë që duhet ta zgjidhim ne me këshill bashkiak që edhe biznesi, edhe Lezha Invest të shkojnë paralel me çmime me një llogjikë, jo me tre lloj skenarësh atje, ku kujt do t'i teket, të bëjë çfarë të dojë.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kush ka diskutim? Zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Atëherë sa i përket sezonit të kaluar, meqë u mor edhe si argument, mendoj që, e kam shprehur dhe në mbledhjet e tjera, është menaxhuar mirë dhe ka patur një reagim pozitiv të qytetarëve sa i përket plazheve publike dhe plazheve të menaxhuara nga Lezha Invest, ashtu sikurse janë mirëpritur edhe tarifat e sezonit të kaluar, 300, 400 dhe 500 lekë të reja për çadër dhe shezllone. Duke lexuar këtë projektvendim, unë konstatoj, ashtu sikurse u sqarua, që Lezha Invest, rrjedhimisht Bashkia Lezhë, do të vijë tashmë në zonën e bregdetit, në plazhet e menaxhuara, edhe me një cilësi tjetër përveç asaj ekonomike, pra premium dhe cilësore, siç sqarohet. Por që praktikisht kjo na çon në një rritje prej dy deri në pesë herë më shumë të tarifave të paketës çadër dhe shezllone në plazhet e menaxhuara. Në këtë projektvendim nuk është sqaruar se sa pjesë të sipërfaqes së plazheve të menaxhuara do të zënë pikërisht këto sipërfaqe të menduara nga ana juaj, ku do të shërbehet në një cilësi më të mirë, premium dhe cilësore. Përveç kësaj, unë mendoj që ndryshimi i kategorisë nga ajo ekonomike është e panevojshme, sepse siç e shpreha dhe në fillim, nga ana e qytetarëve është mirëpritur vjet ky mirëmenaxhimi i plazheve publike, qoftë nga cilësia e çadrave dhe e shezlloneve që ata kanë gjetur, qoftë edhe nga çmimet e vlerësuara të arsyeshme. Pra e shoh të panevojshme që Lezha Invest të ofrojë një shërbim më të mirë sa i përket paketës çadër dhe shezllone, por që na sjell në mënyrë të pashmangshme një rritje prej dy deri në pesë herë më shumë të tarifave në plazhet publike. Nga ana tjetër, e shoh të paarsyeshme që ky ndryshim i kategorisë së shërbimit të paketës shezllone dhe çadër ta çojë shërbimin, tarifën e shërbimit në plazhet e menaxhuara nga Bashkia në të njëjtat nivele me plazhet që menaxhohen nga subjektet private apo me stacionet e plazhit. Pra këtë e shoh unë të paarsyeshme, sepse në fund të fundit, vjet kur miratuaam këtë mënyrë të re të menaxhimit të plazheve, kur për herë të parë u miratua hapësira publike pa pagesë e plazheve, hapësira e menaxhuar nga Bashkia e plazheve me tarifa shumë të arsyeshme dhe me kushte të mira, qëllimi ky ishte, që qytetarët të kenë akses në plazhe, por nga ana tjetër të disiplinonim indirekt edhe subjektet private me tarifa të ekzagjeruara ndër vite. Kështu që për ta përmbledhur, për të mos marrë kohë, e shoh të paarsyeshme që të shkojmë tek cilësia premium dhe cilësore, siç është sqaruar tek projektvendimi, janë mirëpritur standardi ekonomik i çadrave dhe shezlloneve në plazhe dhe e shoh të paarsyeshme që në plazhet e menaxhuara nga Bashkia tarifat të jenë baraz me stacionet private të plazhit. Faleminderit.

-Ndue Luli: Fjala për kryetarin.

-Pjerin Ndreu: E para e punës, stacionet e plazhit që janë të hotelerive, nuk kanë destinacion shitje. Dakord? Shitja nuk është destinacioni i stacioneve të plazhit të dhëna nga shteti për hoteleri. Mbajeni mend këtë të parën. Ajo që ne i lëmë si tolerancë biznesit është në kohën kur ata nuk e kanë hotelin plot dhe për pasojë 10, 20 apo 30 shezllone dhe çadra aty janë bosh, ata vijnë në variantin e shitjes, por që nuk e kanë atribut për ne ia lëmë për të stimuluar biznesin dhe

kjo është një lehtësi që ne ia krijojmë biznesit, por duke i vënë një çmim tavan që ata mos të abuzojnë me hapësirën publike që kanë. Atëherë automatikisht ata hyjnë në kontroll të Bashkisë, ku secili klient do të kontrollohet nëse ka faturë fiskale apo s'ka për pagesën që i ka bërë. E para, që ta dimë mirë. Pra kjo nuk ka lidhje me biznesin. Madje Lezha Invest mund t'i ketë çmimet dhe më shumë, sepse është veprimtari fitimprurëse, duke pasur parasysh ofertën, kërkesat e njerëzve, kërkesat e klientelës, sepse ne jemi përballë me këtë dhe si vepron Lezha Invest. Lezha Invest vepron me një kuotë shezllonesh që i ka blerë vetë, që janë rreth 2000, që i merr, po të tjerat nuk i blejnë dot vetë për momentin, se ne akoma sjemi rentabël dhe detyrohemi të hyjmë në marrëdhënie qeraje. Pra ne i marrim me qera një subjekti X që i ka të magazinuar dhe i ka blerë. Në momentin kur ne e marrim me qera, cilësia e këtyre shezlloneve nuk mund të jetë standard gjithmonë që të jetë niveli bazik i këtyre. Pra disa i kanë standardin me dyshekë dhe nuk është aspak normale dhe kjo është logjike që ne të shkojmë dhe të kemi të njëjtën tarifë si ai e si ky tjetri, kur cilësia është ndryshe. Edhe kur shkon në restorant, kur shkon me pagu për peshk apo për mish, paguan më shtrenjtë për peshk, pra e zgjedh ti. Ne e japim mundësinë, sepse nuk mund ta fusim në një grup klientelën që të gjithë duan të njëjtin sistem bazik të pagesës, sepse na ka rezultuar dhe vjet që aty ku kishim më lirë e kishim cilësi shezllonesh më të ulët, prezenca ishte më e vogël. Nuk është më klientela si dikur. Kërkon më shumë kushte. Nëse kërkon më shumë kushte, do paguajë më shumë. Nëse don me qenë me zero, ke hapësira 30% me zero dhe ke mundësi. Hapësirat me zero vjet s'kanë qenë as 15% të zëna atje, bosh ishin, bosh ishin dhe nuk shkonin. Ne e japim mundësinë që të ketë plazh publik dhe ky rankim është normal, se vjen nga me zero lekë, vjen me tre, e don me katër, e don me shtatë, e don me tetë, e don me 15. Ne e kemi hapësirën. Pra ne nuk jemi duke mbyllur një hapësirë, që ai nuk e ka një mundësi dhe t'i krijojmë vetëm ta çojmë atje se s'bën. Nuk e kemi këtë. Ne e japim mundësinë, por ama është krejt normale që cilësia e ndryshme të ketë pagesa të ndryshme. Edhe Lezha Invest, nëse e merr një strukturë me qera shezllonesh dhe ato janë cilësisht shumë më lart sesa këto të aluminit, normalisht është më shumë. S'ka sens ajo. Këtë po bëjmë ne. Ne nuk barazohemi me biznesin. Biznesit thjesht i lëmë lirshmërinë që t'i shesë gjë që s'e ka si atribut, se nuk e merr për me e shitë atë. Ai e merr për klientelën e vet, 1 çadër me 2 shezllone.

Pra biznesi nuk është veprimtari fitimprurëse aty me shezllone. Shezllonet ia lëmë ne. Pra një gjë, të qartësohemi. Shezllonet që i merr njësia akomoduese X, nuk i merr me i shitë, po i merr se unë kam kaç klientelë në dhoma, kam 100 dhoma dhe do marr 200 shezllone. Dhe i merr për dhomat ai. Ne, duke u treguar fleksibël e duke i lënë mundësinë që në 10 dhoma bosh që ka, që i bie 20 shezllone, në 20 dhoma bosh që ka, që i bie 40 shezllone, ai mund t'i shesë. Po me kusht. Mund t'i shesë me çmimin tavan që ia vendos. Në momentin që vjen te shitja, ai vjen te logjika e tregut që kemi vendosur ne, ne si këshill këtu. Ja vendosim ne çmimin.

Dhe e dyta që ta kuptoni, është ngritur një problem edhe dje. Sepse për shembull, Lezha Invest i merr 100 shezllone, lë dhe punonjësin e vet aty. Lezha Invest paguan, në qoftë se në 100 shezllone ti nuk i ke shfrytëzuar, se i ke kërkuar 100 ose i kam marrë unë 100, ti ke shfrytëzuar 60, unë për 60 do të paguaj ty. Jo për 100. 100 që i ke lënë bosh. Jo po, m'i jep ti të gjitha. Si t'i jap të gjitha? Atëherë unë këtu nuk do vendos 60. Do bëj 100, por do vendos 60 herën tjetër që të jemi kokë më kokë. Jo erdhën 5 më shumë sot, jo erdhën 5 më shumë nesër. Ne si Lezha Invest nuk shpenzojmë lekë. Nuk japim lekë jashtë koeficientit të shfrytëzimit. Prandaj e kemi çuar me koeficient shfrytëzimi. E shfrytëzon 60%, 60% të qerasë do marrësh. Jo më shumë. Që të ruajmë shpenzimet, të mos bëjmë shpenzime edhe pastaj të dalin ata të marrin lekë prej qerasë e kur vjen

puna me pagu shtetin Lezha Invest dhe shtetin ta paguajë 60%, qeranë ta marrin për 100%. Është anormale. Unë mendoj që rregullim më të saktë se ky, duke i rankuar edhe cilësitë, sepse ma kanë kërkuar, nuk ka.

-Alfrida Marku: Sa përqind do të kenë plazhet e okupuara?

-Pjerin Ndreu: Tani, kjo është fleksibël. Kjo nuk është e paracaktuar. Ne 30% jemi të detyruar me i lënë hapësirat bosh, me ligj. Në të gjitha të tjerat pastaj, sa kemi ne shezllone si Lezha Invest, do shtrihen në disa parcela, edhe të tjerat që do merren me kështu, do jenë të detyruar me tabelë. Do të jetë plazh publik i menaxhuar me çmime reference. Edhe hotelëritë do të vënë tabelat me çmimet përkatëse aty. Në qoftë rasti që shitet shezllone, do ketë tabelë, çmime që shpiken nga mendja e kërkujt, nuk do të ketë më. Sigurisht e kemi me vendim të Këshillit Bashkiak. Pra ne jemi duke vënë disiplinë në këtë punë dhe unë mendoj se jemi duke bërë një shërbim të jashtëzakonshëm, duke i lënë mundësi të gjithë fashave të klientelës të akomodohen sipas kërkesës së tyre.

-Ndue Luli: Faleminderit. Mendim tjetër ka? Zoti Tonin.

-Tonin Jaku: Përshëndetje të gjithëve. Përsa i përket shellzoneve, në qoftë se Bashkia do hyjë në pazar në privatin, aty është e pamundur që të kërkosh llogari. Pastaj jepet 8000, 10000, 12000 lekë, e para. E dyta, ka hotele që janë të certifikuara nga Ministria e Turizmit dhe pajisen me shezllone në vijë të parë, ku unë kam vu drejtorin në dijeni edhe vjet edhe sivjet dhe nuk e di arsyen pse. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti kryetar.

-Erdhi këshilltari Elton Bilani.

-Pjerin Ndreu: E para e punës, kjo shprehja “Pazar” s’është për këtu njëherë, është komplet palidhje me këtë histori, se të gjitha procedurat bëhen me kontratë të firmosur dhe ne s’mund të firmosim pazare.

E dyta, do ju kërkoj që të keni kujdes me terminologjinë, se këtu jemi me vendim këshilli. Po të ishim duke e bërë në mënyrë arbitrare, mund të thuash pazar. Ne jemi duke e bërë në këshill dhe jemi duke e diskutuar publikisht. Kemi bërë dje konsultim dhe diskutim me 150 operatorë turistikë. Më hapur se kaq, e më qartë se kaq, më pa pazar se kaq, unë nuk di ndonjë stacion plazhi deri sot që ka paguar 1 lekë. Dikur po, sot jo. S’ka shans. Dhe jo sot, e nesër, e pasnesër, po sa të jem unë kryetar i Bashkisë, i dal kujtdo përballë se kurrë nuk është abuzuar dhe nuk është shkelur ai kod i transparencës, i të drejtës, i korrektesës në raport me këto. Mendojeni te lokali, në mbledhjen e këshillit nuk është mirë me i nxjerrë këto. Edhe me i thënë pa bazë.

Tani, që ka ndonjë hotel që s’ka mundësi, nuk akomodohet dot për shkak të mospasjes së hapësirës publike aty, ka. Dhe kjo nuk është domosdoshmëri 100% që një hotel duhet patjetër ta ketë atë. Nuk ka vend, s’ka mundësi. Ka vend, ka mundësi. Kaq. Edhe kur ka qenë vjet, kur ka qenë e pamundur me e bë, ne kemi hyrë me Lezha Invest me i dhënë mundësinë. Pra ia kemi marrë me qera shezllonet dhe ia kemi lënë në përdorim po hotelit që me i kriju lehtësira. Ne kemi qenë pikë për pikë. Tani të bëjmë ne konsultë me 150 operatorë dje për dy orë dhe mos të kemi një vërejtje, një problem, media ka qenë aty është dhe këtu dhe mos të kemi një qarje halli e të vij tani të dëgjoj kësi lloj shpikjesh këtu, mua më vjen shumë keq, është e parregullt.

Marrëdhëniet tona me operatorët turistikë janë super korrekte, super të ngushta në komunikim intensiv, qartë e saktë, pa as edhe një lloj interference negative.

-Ndue Luli: Faleminderit. Tjetër nuk ka. Atëherë kush është dakord me projektvendimin, ju lutem kartonat? Miratohet me 25 vota Pro. Këshilltarët Alfrida Marku, Tonin Jaku, Gjon Marku votuan abstenim, 3 vota abstenim. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën 6, projektvendimin “Për miratimin e plan-masave për parandalimin, menaxhimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve për vitin 2026”. Në lidhje me këtë projektvendim, kush e do fjalën? S'ka. Kush është dakord me projektvendimin, ju lutem kartonat? Miratohet me votat pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 28 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 7, Projektvendim “Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK”. Në lidhje me projektvendimin, një nga projektvendimet që faktikisht ka ca mbledhje që nuk i kemi pasur në rendin e ditës së mbledhjeve, por që shpresojmë që edhe në të ardhmen të shtohen akoma më shumë në lidhje me këtë. Kush ka ndonjë mendim? Nuk ka. Atëherë kush është dakord, ju lutem kartonat? Miratohet me votat pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 28 vota Pro. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën 8, Projektvendim “Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore”. Ka kush ndonjë mendim? Nuk ka. Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 28 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 9, Projektvendim “Për miratimin e akordimit të fondit për shpërblimin e sportistit kampion kombëtar”. Ka kush ndonjë mendim? Nuk ka. Atëherë kush është dakord për projektvendimin? Miratohet me votat pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 28 vota Pro. U shtofshin më shumë kampionët kombëtarë për Lezhën, pasi edhe sportet po ecin përpara, kështu që është diçka shumë pozitive.

Vazhdojmë me pikën 10, Projektvendim “Për ndryshimin e emërimit të degëzimit të Rrugës së Shelbumit, që mban të njëjtin emër dhe të marrë emrin “Hil Simon Hila”, në qytetin Lezhë”. Bëhet fjalë për një degëzim të rrugës kryesore të Shelbumit, që del nga rruga “Gjergj Fishta”. Është kërkesë e banorëve, ka gati katër muaj. Keni dhe dokumentacionin aty. Keni edhe hartën e marrë nga Drejtoria e Urbanistikës. Ka kush ndonjë mendim? Po zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Tashi me këto projektvendime dhe na vini në pozitë, me thënë të drejtën, por paraprakisht unë duhet të shpreh që të njëjtin qëndrim do kisha mbajtur për këdo. Pra nuk është çështje e individit, në mënyrë absolute. Përkundrazi, gëzoj respekt maksimal dhe jo pa shkak thashë që na vini dhe në pozitë. Ne si banorë që ndajmë të njëjtin qytet, të njëjtën rrugë, edhe këtu dihet se ku e kam vërejtjen personalisht. Së pari, në aspektin procedural unë i referohem projektvendimit, si pjesë e kryesisë së këshillit, nuk ka pasur një mbledhje të kryesisë së këshillit të bashkisë. E rrjedhimisht, ky projektvendim nuk është diskutuar për t'ju hapur rrugë për të kaluar në këshillin e bashkisë. Për të shkuar tek thelbi i çështjes, duke filluar të paktën 10 vitet e fundit, e kur them 10 vitet e fundit, mbaj edhe përgjegjësitë e mia, për aq sa mundësi dhe autoritet kam pasur, janë bërë shumë gabime. Nuk po përdor fjalë tjetër, por është gabuar shumë me emërtimin e rrugëve, ashtu sikurse edhe me një praktikë të shfrenume, pse jo, jo qytetar nderi, jo mirënjohja e qytetit. Pra është mirë që të gjithë me reflektu edhe me i vu kufi nismave të

tilla. Unë mendoj që, pavarësisht respektit maksimal që ne gëzojmë për njëri-tjetrin, edhe këtu dua ta ripërsëris, të njëjtin qëndrim do kisha mbajtur edhe sikur aty të ishte mbiemri Dedgjonaj apo edhe Marku. Pavarësisht respektit maksimal që ne gëzojmë për njëri-tjetrin, nderimi dhe respekti për një individ nuk mund t'i mbivendoset historisë së një komuniteti. Unë nuk mund ta pranoj që emri "Rruga e Shelbumit", që është një festë fetare që e feston mbarë Lezha, kryesisht Malësia e Lezhës, tre javë pas Pashkëve, për ata që nuk e dinë, të hiqet.

-Ndue Luli: Nuk hiqet.

-Alfrida Marku: Pra gjeni një degëzim tjetër nga një rrugë lagjeje që me e respektu, meqë është edhe nisma juaj personale, tash unë po e shpreh dhe këtë.

-Ndue Luli: Po ma thua ti personale, po s'është personale.

Zonja këshilltare, të lutem, më fal për ndërprerjen. Më fal se po të ndërpres.

Tani, po ta shikosh në projektvendim, thuhet, për ndryshimin e emërimit të degëzimit të rrugës së Shelbumit, që mban të njëjtin emër, pra, sqarova pak përpara, rruga kryesore që del nga bulevardi "Gjergj Fishta" dhe vazhdon lart te spitali dhe deri në Kodër, e ruan atë emërtim, aty është një degëzim rruge e cila shkon afërsisht, nuk mund të them me metra kështu, por rreth 150 metra, ku të gjithë banorët që banojnë në dy anët e kësaj rruge, është tepër transparente, po të jenë këtu ata jam i sigurt që do të thonë që secili ka marrë pjesë në firmosje, kanë kërkuar që vetëm degëzimit të rrugës që ndahet nga rruga kryesore që është e Shelbumit, t'i jepet ky emërtim. Ky është degëzimi. Kuptojeni mirë. Dhe harta që keni përpara, e ka të nënvijëzuar, po ta shikoni me kujdes. Kështu që ky është ai dokumentacioni i cili ndodhet përpara secilit prej jush.

Megjithatë, katër anëtarë të kryesisë së këshillit kemi bërë takimin për këtë problem. Nuk je njoftuar, jo për ndonjë gjë, të lutem, por kështu ka qenë situata, por që katër anëtarë të kryesisë kanë qenë prezentë kur është diskutuar problem i kësaj rruge. Është diskutu problemi i rrugës, është diskutu edhe projektvendimi që vjen pas këtij projektvendimi, për të cilin do flasim pas këtij. Po zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Unë ndaj të njëjtin shqetësim që ndan zonja Marku. Emërtimet e rrugëve janë bërë diçka pak si e çuditshme, me thënë të drejtën, ku kushdo merret me i vu emrat e babë, nënë, e vëlla, e motër, e ku e di unë. Çfarë përfaqëson ky emër? Që t'i vësh një rruge qyteti një emër, na duhet që të ketë një CV shumë të fortë. Nëse s'ka një CV të fortë që të na mbushë mendjen ne, se ajo rrugë e meriton ta ketë emrin e një personi, qoftë edhe babai im, të jetë, mua s'më duket normale. Singërisht. Dhe ne në këshill, unë jam në vitin e shtatë të kësaj, bashkë me dy këshillat, ne s'kemi bërë as 5-6 vetë, duke i shtuar këtu edhe 2-3 që janë jashtë Lezhës, për shkak të impaktit në Lezhë, s'kemi bërë qytetarë nderi, e kemi shtrënguar. Por edhe me e liru me këto rrugët, unë nuk jam dakord. Unë jam dakord me një gjë. Duhet një studim që rrugët që janë të paemërtuara t'i emërtojmë, por të kemi kujdes. Kështu nuk është me i bë nder njërit, as tjetrit, unë nuk e di fare se kush është. Po cila është CV-ja e zotërisë?

-Ndue Luli: Ta sqaroj pak. Në atë kërkesë që është bërë nga banorët që banojnë në këtë rrugë, nuk e di sa mund të jetë numri, shkon rreth 30, mos gaboj, është shkruar se është banori i parë që është vendosur në atë pjesë të lagjes së spitalit. Dhe e dyta, është rrugë e hapur privatisht, hapur

nga ai, investuar nga ai. Tjetër, ai nuk jeton më, ka disa vite dhe ka qenë kërkesa e banorëve, ne po e shtrojmë këtu. Këtu e vendosim.

-Pjerin Ndreu: Për mendimit tim ky nuk është kriter, hapi rrugën i pari.

Në qoftë se një personalitet, nuk e kam fjalën vetëm për këtë rast, në qoftë se nuk ka rrëzuar në aktivitetin e vet, efekte publike, në arsim apo në kulturë apo në çështje të tjera të mëdha sociale apo shëndetësore apo diçka, jo hap rrugën i pari, jo i treti, jo i pesti, duhet një gjykim që ky këshill nuk do të bjerë në nivelin e kësaj. Kaq.

-Ndue Luli: Po, zoti Gjinkola.

-Pjeter Gjinkola: Në lidhje me rastin e parë, pra për atë sportistin, shumë okej.

-Ndue Luli: Të lutem, mos ta marrim në diskutim, meqenëse e kaluam.

-Pjeter Gjinkola: Unë e di se edhe me ligj, një sportist dhe kampion vendi merr shpërblim. Është gjë shumë e mirë me e stimulu. Si rregull edhe trajneri duhet të respektohet.

-Ndue Luli: Mirë, e dëgjuam këtë. A ke tjetër për këtë projektvendimin në fjalë?

-Pjeter Gjinkola: Ky vendim, si rregull ligjërish, tash se di kush e mbulon te bashkia, duhet me e pa ligjin mirë se 99%, mos them 100%, duhet të jetë një klauzolë kur një person del kampion për një klub ose për një shtet, automatikisht me përqindje duhet të respektohet edhe trajneri përkatës.

-Ndue Luli: Faktikisht na u kthye mbrapa pak këshilltari kryetar, kështu që shkurtimisht mund ta sqarosh.

-Pjerin Ndreu: Ne i paguajmë trajnerët me rrogë. Sportisti merr kur del kampion, trajneri merr për çdo muaj.

-Ndue Luli: Atëherë fjalë tjetër kush e do? Zoti Tushaj.

-Pjeter Tushaj: Unë e kam njohur personalisht Hil Simonin, meqenëse kam ardhë herët në Lezhë, edhe unë mendoj që ai ka qenë njeri punëtor, njeri i jashtëzakonshëm. Unë me thënë të drejtën, nuk kam as lidhje gjaku e as ndonjë lidhje tjetër, po unë e kam njohur personalisht. Edhe në qoftë se nuk dëmtohet edhe rruga e Shelbuemit, për atë degëzim që bëhet fjalën, për mua ai e meriton edhe unë jam plotësisht dakord. Për një degëzim 100 metra, çfarë do të prishte një njeri që ka vdekur, njeri shumë i mirë ka qenë, pse mos t'ia vëmë emrin, që këtu kanë marrë emra njerëz të gjallë që kanë vu para ca kohësh, sot janë gjallë, që unë s'jam dakord fare. Kështu që nuk ka pse diskutohet kaq thellë kjo punë.

-Ndue Luli: Mendim tjetër? Zoti Pjetër.

-Pjeter Noka: Unë jam dakord me mendimin e z. Tushaj, meqenëse nuk ndryshohet emërtimi i parë. Të vazhdojmë me këtë, të kalojmë, të kemi kujdes për herë të tjera.

-Ndue Luli: Zoti Artan e ka fjalën.

-Artan Ndreu: Përshëndetje të gjithëve. Unë jam kundërshtari kryesor i vendosjes së emrave të rrugëve, dihet, dhe për rastin konkret nuk kam gjë se nuk e njoh personin, por nuk duhet të biem

me grackën, se ligji e ka përcaktuar saktë se kush me marrë emra rrugësh e tituj të tillë. Duhet të jetë sipër normales, ashtu siç e shpjegoi edhe kryetari, që duhet të jetë njeri mbi mesataren. Nuk e di se kush është ky, po unë mendoj se këtu nuk është t'i bëjmë me shpërnda ndihma. Është ma keq kur e heq ai tjetri, se do vijë këshilli tjetër ta heqi.

-Pjerin Ndreu: Edhe njëherë një shpjegim se mua më shqetëson si kryetar bashkie kjo gjë. Ta kalojmë edhe këtë herë që tha Pjetri, unë jam jashtë kësaj. Që mund të jetë burrë i mirë, familjar i mirë, njeri me reputacion, këtu nuk kam unë dyshim, s'kam të drejtë unë me diskutu. Ama të marrë emrin një rrugë, duhet të kesh bërë një shenjë të fortë në jetën publike të një qyteti. Në qoftë se do bëjmë kështu qoka personale të njërit e tjetrit, kjo është një gabim. Do ta fusim në kolaps dhe pastaj do përballemi me lloj-lloj qyfyresh. Mos të shkelim në këto dërrasa. Në qoftë se unë e kam kushëri dhe është burrë i mirë, le të jetë burrë i mirë. E kam pasur shok, le të jetë burrë i mirë. Që të marrë emrin e rrugës, më vjen shumë keq, as e njoh as e di, s'kam lidhje me këtë. Por që të marrë, duhet të ketë një CV të fortë. Duhet të na shpjegojë se në jetën publike të Lezhës ka bërë këto gjëra dhe ka ndryshuar këto gjëra në dobi të komunitetit. Unë për vete i bëj thirrje grupit tim socialist që të mbajë qëndrim, sepse është absurde që të shkojmë e të marrim vendime të tilla. Nuk preferoj as edhe një shenjë. Nuk kemi bërë ne iniciativë. Nuk është iniciativa jonë e bashkisë kjo. Dhe unë nuk marr të tilla iniciativa. Fare. Unë nuk hyj se jemi përballë me lloj-lloj historish. Jo më vdiq djali në Itali, jo më vdiq nëna në Itali, jo, baba kështu, e ti vemë rrugën kështu. Më vjen shumë keq, po përtej dhimbjes që ndjejmë për njerëzit që ikin e janë larguar, ne nuk mund ta kthejmë këshillin në një histori qokash. Nëse do e marrin, do e marrin një personalitet që ka lënë shenjë në jetën publike dhe ka ndihmuar njerëz, ka bërë një akt që ka sjellë dobi të ndryshme në komunitet dhe unë jam absolutisht kundra çdo lloj hapje rruge të tillë.

-Ndue Luli: Po, zonja Marku.

-Alfrida Marku: Vetëm dua një ilustrim të fundit për me e lidhë edhe me një rast tjetër të njëjtë, por që siç e tha Artani, vjen momenti që në këshill diskutohet për ta zhbërë një vendim të gabum. Unë dua me e lidhë me një rast në fshatin Kakarriq, lagjja Dragiaj, ku para shumë kohësh është ndryshuar emri i asaj rruge. Nga lagjja Dragiaj, pra një toponim i përdorur prej viteve 1290, që do të thotë pikë doganore në terminologjinë e asaj kohe, ky këshill, me sa e di, apo tjetri, ka marrë vendim që të heqë emërtimin e rrugës Lagjja Dragiaj dhe t'i vendosë emrin e një individi që jeton në atë lagje.

-Ndue Luli: Të lutem znj. Marku, e kemi për mbledhjen tjetër. Dhe kërkesa e atyre banorëve do të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme. Ta dish dhe këtë.

-Alfrida Marku: Banorët i janë drejtu këshillit të bashkisë që me e rikthy emërtimin e mëparshëm, ne e kemi depozituar në protokoll me 24 shkurt, kështu që në këtë linjë arsyetimi unë i kërkoj kryesisë së këshillit, por edhe bashkisë që të marrin masa për ta përfshirë në rend dite sa më shpejt në mbledhjet e këshillit të bashkisë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Atëherë, në lidhje me këtë, që të jenë të qartë këshilltarët e tjerë, për propozimin që dha zonja këshilltare në lidhje me rrugën Kakarriq, mbledhjen e ardhshme do të shqyrtohet sepse banorët e asaj lagjeje kanë dërguar kërkesën këtu, me kryetarin e njësisë administrative jemi takuar për ta biseduar dhe do të shqyrtohet po këtu. Në lidhje me projektvendimin që e lexuam,

mendim tjetër s'ka. Sa për dijëni, në bazë të ligjit veprohet për të paraqitur kërkesat e qytetarëve në këshillin bashkiak. Dhe edhe unë si kryetar i këshillit, por edhe çdo anëtar i këshillit, secili nga ju ka të drejtën e tij legjitime që të paraqesë opsione, propozime për problematikat, për rrugët, për qytetarët, për të gjitha. Ligjin ne e dimë secili, kështu që s'kam nevojë t'jua bëj të ditur. Dhe sikur ta kisha sjellë unë individualisht, një e drejtë e imja legjitime është, është këshilli ai që e diskuton dhe e miraton ose e hedh poshtë. Unë për vete, meqenëse janë rrethanat e mia kështu, abstenoj në këtë projektvendim, por jam i detyruar ta hedh në votim. Kush është dakord?

Rezultati i votimit: 10 vota Pro nga këshilltarët Marin Suta, Argert Perkola, Marko Jaku, Elton Bilani, Dod Jaku, Shtjefen Lleshi, Rrok Marku, Tonin Jaku, Gjon Marku, Pjeter Tushaj.

2 vota Kunder nga këshilltarët Alfrida Marku, Artan Ndreu.

16 vota Abstenim nga këshilltarët Ndue Luli, Ervin Coli, Silvana Kola, Jorida Mikaj, Drimona Marku, Klejvi Hoxhiqi, Elsa Gazulli, Pjeter Gjinkola, Klevis Bezhi, Flutura Gjoni, Fjorixhena Zefi, Alfons Trashaj, Klaudia Doda, Pjeter Noka, Gjuljana Seferaj, Emirjon Mali.

Meqenëse 10 janë pro, 2 janë kundra dhe 16 abstenim, nuk miratohet.

Vazhdojmë me pikën 11, Projektvendim "Për miratimin e zgjedhjes së anëtarëve të kryesive dhe kryetarëve të tre fshatrave në Bashkinë Lezhë".

Në lidhje me këtë projektvendim, dua të sqaroj. Ju, të nderuar këshilltarë, keni informacionin që e kemi patur për zgjedhjet për kryetarët e fshatrave që në muajin mars, se si janë zhvilluar zgjedhjet në të gjitha fshatrat për të cilat është marrë vendim këtu në këshillin bashkiak dhe nga shqyrtimi i gjithë dokumentacionit që ndodhet në këshillin bashkiak, vetëm tre fshatra e kanë të rregullt dokumentacionin, pikërisht fshatrat për të cilët i keni dhe në relacion, bëhet fjalë për fshatin Rrilë, fshatin Tresh dhe fshatin Kodër Mulliri. Kurse në të gjithë fshatrat e tjerë, duke pasur parasysh dhe relacionin që keni përpara, ka mangësi në realizimin e zgjedhjeve të kryetarëve të fshatrave dhe të anëtarëve të kryesive. Mua më vjen shumë keq, pasi një pjesë e mirë e këshilltarëve gjatë fushatës së zgjedhjeve të kryetarëve të fshatrave dhe të anëtarëve të kryesive, kanë qenë tepër korrekt duke shkuar në ditën, orën e caktuar nëpër fshatra, si në njësinë administrative Ungrej, Dajç apo diku tjetër, dhe më vjen keq që janë munduar, por duke u nisë nga ajo që ka qenë një prezencë shumë, shumë e ulët në mbledhjet e lagjeve për zgjedhjen e anëtarëve të kryesive, duke qenë se në disa lagje në vend që anëtarët e komisionit të zgjidheshin nga elektorati i lagjes, sepse kështu është përcaktuar edhe në vendimin që kemi marrë këtu në këshill, ka pasur anëtarë të komisionit nga vetë kandidatët për anëtarë kryesie. Dhe arsyeja e tretë ose shkak i tretë që nuk miratohen këto gjashtëntë fshatrat e tjerë, që kemi paraqitur relacionin për mosmiratim, është se ka çaluar edhe funksionimi i Komisionit Monitorues për zgjedhjet në këto fshatra. Duke u nisur nga kjo, ne kemi paraqitur projekt vendimit që të miratohen tre fshatrat: Rrilë, Tresh dhe Kodër Mulliri, kurse të tjerët, në bazë të ligjit, t'i kalojnë kryetarit të Bashkisë për emërim. Kush ka ndonjë mendim? Zoti Gjon.

-Gjon Marku: Përshëndetje të gjithëve. Ky projektvendim krijon dy standarde. Së pari, në pikën një pranohen zgjedhjet për disa fshatra, ndërsa në pikën dy fshatrat e tjerë nuk janë përfshirë dhe nuk janë realizuar zgjedhjet dhe i kalon kompetenca kryetarit. Ndërkohë, në disa nga këto raste ka pasur tentativa dhe procese. Mbi të gjitha kemi precedent. Në të njëjtën zonë njësi administrative, para tre viteve kemi zgjedhur kryetar fshati me 10 banorë të asaj lagjeje. Marr

Njësinë Administrative Ungrej. Në pjesën më të madhe të këtyre fshatrave janë zgjedhur me 10 banorë, ndërsa sot nuk pranohet si standard dhe vendoset si standard kriteri i pjesëmarrjes. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit edhe ty. Sqaroj prapë, nuk është vendosë si standard vetëm pjesëmarrja e banorëve në zgjedhjen e anëtarëve të kryesive të lagjeve dhe të fshatrave, konkretisht edhe për fshatrat e Njësisë Administrative Ungrej, por është dhe diçka tjetër, një shkelje tjetër, që ka të bëjë me anëtarët e komisionit për zgjedhjen e anëtarëve të kryesive, pasi ka qenë dhe vetë kandidati për anëtar kryesie si komisioner. Kjo është një shkelje në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak që e kemi marrë së bashku këtu, sepse është përcaktuar qartë: në komisionin e zgjedhjes së anëtarit të kryesisë zgjidhen tre veta, pasi propozohet se kush do të jetë anëtar kryesie, zgjidhen tre veta për të qenë anëtarë komisioni dhe monitorohet ky komision i lagjes nga Komisioni Monitorues që është caktuar pikërisht nga Këshilli Bashkiak. Pra, konkretisht për njësinë në fjalë, janë dy arsye. E para, pjesëmarrja e dobët, se kemi lagje që është me tre, me katër apo gjashtë banorë. Pra, tre, katër apo gjashtë banorë. Të lutem, kemi atë procesverbalin atje, e kemi të dokumentuar. Kur të dëshironi, i keni të hapura me i pa dhe e dyta është se ka patur në komision vetë anëtarin, ose më mirë të themi, vetë kandidatin për anëtar kryesie.

-Gjon Marku: Në cilën lagje konkretisht?

-Ndue Luli: E ke këtu, ti lexoj unë. Për shembull, në fshatin Fregën ka qenë më 12.02.2026, janë zhvilluar zgjedhjet në dy lagje, ndërsa nuk janë zhvilluar në një lagje tjetër. Atëherë, anëtarët e këshillit, që janë edhe anëtarë të komisionit monitorues të zgjedhjeve, kanë firmosur edhe si anëtarë komisioni, që nuk lejohet anëtarët e këshillit me firmosë në komisionin e zgjedhjes së anëtarit të kryesisë. Besoj se më kuptove me këtë. Anëtarët e këshillit firmosin te procesverbali i zgjedhjes së kryetarit të fshatit.

Asnjë fshat që i ka këtë që po them unë, nuk do miratohet për arsyen se janë bërë këto shkelje dhe e ke te relacioni të qartë në tre fjali.

-Gjon Marku: E ke miratuar para tre vitesh.

-Pjerin Ndreu: A mund të sqaroj, të jap një sqarim se më duket se s'jeni duke u sqaruar mirë.

-Ndue Luli: Po.

-Pjerin Ndreu: E para është që janë bërë gabime proceduriale në zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave që afektojnë punën drejtpërdrejtë me bashkinë, janë strukturat ndihmëse të funksionimit të pushtetit lokal, që të jemi të qartë. Normalisht që zgjidhen nga pushteti lokal. Në qoftë se janë bërë gabim para katër vitesh, nuk do të thotë që do të bëjmë gabim prapë njëherë, që ta kesh të qartë. Dakord? Se nuk mund të marrësh referencë një gabim, që të bëjmë një gabim tjetër. Dakord? Është bërë gabim shumë, se je këshilltar këtu dhe nuk të lejohet me bë kështu deduksionesh. Në qoftë se është bërë një gabim para katër vitesh, s'mund ta sjellësh si argument pse s'e bën prapë. Dakord? Dhe ne nuk mund të zgjedhim kryetarë fshatrash me qoka, me njerëzit e vet të shtëpisë. Më vjen shumë keq. Dhe sa për dijeni, si referencë janë listat e zgjedhësve, dhe në listat e zgjedhësve në fshatin filan ne na figurojnë shumë njerëz. Ndoshta me ligj është gabim, sipas meje. Dhe ne kemi pranuar një standard që të shkojmë te 20-30

kryefamiljarë që jetojnë atje, por jo te 4-5. Më vjen shumë keq. Një kryetar fshati nuk mund të përfaqësojë asgjë kur në lista më figurojnë 100 votues e të zgjidhet me 10. Është absurde kjo. Atëherë, në qoftë se doni ta ngremë standardin, edhe këta që kemi thënë, po të ishte puna për politikisht, po të them unë, njërin prej këtyre s'du me e pa fare, as don me pa as mua. Por nuk mendojmë që duhet të gjykohet politikisht. Sa kanë marrë pjesë në Rrilë? 35. Të paktën ka një numër optimal njerëzish e kryefamiljarësh që kanë ardhur. Dhe në qoftë se është për t'i zgjedhur të gjithë komplet, sepse me ligj, me listat e zgjedhjeve, le që listat nuk janë publiku njëherë, që e kam ndjekur edhe unë me strukturat e mia. Listat s'janë publiku fare në njësinë Ungrej, një muaj para, që të njoftohen njerëzit. Unë jam dakord që në qoftë se do ta çojmë standardin, ta heqim edhe këtë me 30 dhe 35, ta çojmë zero, i emëroj unë, e kryhet ashtu, s'mund të merrem me mbledhë në katund njerëz. Mos të vijnë njerëz të më thonë, aman derman, hajde ti edhe më mbledh njerëz. Ma kanë bërë këtë njëherë, dy herë, por unë e quaj të tepërt të më thotë mua dikush, hajde më mbledh njerëzit ti dhe t'i çoj votat unë filanit në kuti. Harrojeni këtë punë, s'ka për ta bërë. Por nga ana tjetër, unë nuk mund të bashkëpunoj me një kryetar fshati që ka dalë me votat e shtëpisë së vet. Edhe ne ta paguajmë me lekët e taksapaguesve lezhjanë. Jo, nuk bëhet ajo punë, e s'ka për t'u bërë asnjëherë. Nëse është bërë gabim, s'ka për t'u bërë më. Në këshill nuk mund të përdorësh atë referencë. Është bërë gabim. Po, është bërë, i kemi mbyllur ne sytë. Unë i kisha të emëruar dhe mund të vazhdoja me emërim pa problem se s'kisha ndonjë kokëçarje fare. Unë mendova që të bëhet demokratike kjo punë, që të zgjidhen. Po jo të zgjidhen me qejfin e njërit e tjetrit. Të zgjidhen me procedurë. Është turp që ne të shkojmë në këtë standard. Nëse nuk duan, e nëse s'duan me marrë pjesë, e nëse një person nuk ka reputacionin e duhur që të mbledhë numrin e njerëzve atje, çfarë kryetar fshati do të bëhet ai?

-Ndue Luli: Zoti Trashaj e ka fjalën.

-Alfons Trashaj: Përshëndetje të gjithëve. Kjo rizgjedhja këtyre kryetarëve të fshatrave, po e ripërsëris unë, në gjitha fshatrat janë zgjedhë si janë zgjedhë më përpara si tha dhe kryetari, mos të kthehena ma mbrapa. Çfarë është bërë? Unë kam qenë në Dajç, kemi shkuar shtëpi për shtëpi me kolegët e mi, shtëpi për shtëpi. Nuk ishte i zoti as administratori, as edhe ai që donte me dalë kryeplak, me mbledhë dy veta. S'ka njerëz thoshin.

Këto t'i kalojnë bashkisë.

-Pjerin Ndreu: Unë i kisha të emëruar dhe nuk e pranova më. A po tashti në kushtet kur këta nuk funksionojnë, ne kthehemi prapë.

-Alfons Trashaj: Ne s'mund të shkojmë të nxjerrim njerëzit nga shtëpia për të votuar për filanin, për filanin. Kishteraste që donin të`u merrnin kartat familjarëve jashtë shtetit. Ne s'i kemi pranuar faktikisht, vetëm personat që kanë qenë prezent. Ato kanë qenë prezent, ato kemi bërë. Dhe unë nuk jam dakord më të merremi me ato punë.

-Ndue Luli: Qartë. Nga anëtarët e këshillit tjetër kush e do fjalën?

Atëherë për sqarim për këshilltarët. Zoti Prend Hila nga fshati Tresh ka bërë një kërkesë me shkrim, ku ka paraqitur edhe objektin e ardhjes së sotme në mbledhjen e këshillit. Kështu që zoti Prend, sipas pikave që ke bërë në kërkesë, e ke fjalën tre minuta.

-Foli Z. Prend Hila i cili ngriti shqetësimin e tij në lidhje me zgjedhjet e kryetarëve të fshatrave.

-Ndue Luli: Kush është dakord me projektvendimin, duke pasur për bazë tre fshatrat, dhe të tjerat t'ia kalojmë kryetarit të bashkisë për emërim. Miratuhet me 24 vota Pro. Këshilltari Gjon Marku votoi Kundër. Këshilltarët Klevis Bezhi dhe Elton Bilani abstenuan, 2 vota Abstenim. Këshilltarja Alfrida Marku nuk votoi. Faleminderit.

Kalojmë te pika "Të ndryshme". Dua t'ju vë në dijeni, zonja dhe zotërinj këshilltarë, në lidhje me kërkesat që kanë ardhur në këshillin bashkiak, ku njëra ishte e zotit Prend Hila, e cila u ezaurua gjatë diskutimit të projektvendimit. E dyta është kërkesë e këshilltarit Pjetër Gjinkola. Kërkesë e cila është bërë me shkrim, por meqenëse është vetë anëtar i këshillit, ai do ta thotë vetë kërkesën që ka. Fjala për ju, zoti Gjinkola.

-Pjeter Gjinkola: Bëhet fjalë për një ndër pallatet më të mëdha të banimit të Shëngjinit me pesë seksione, ka 121 hyrje dhe ka rreth 20e ca biznese në katet e para. Dhe vjet u bë diçka që s'kishte ndodhur asnjëherë për shkak të rrugës së Velipojës, dhe faktikisht në Shëngjin u kriju një ngërç i paprecedent në emër të llogjikës se do i shërbejmë turizmit dhe duke harruar qytetarët, duke harruar njerëzit, banorët që jetojnë aty. Dhe unë këtë kërkesë e kam bërë me një llogjikë që të rishikohet gjykimi që është bërë te ai pallat, që të verifikohet, të rishikohet gjykimi dhe të shihet a ka hapësirë a s'ka, se e ka pasur, është hapësira, ekziston, po u bë me devijime. Diku është hapësira, se faktikisht ku ka trotuar, ku ka banesa dhe ku ka ndriçim, duhet të ketë një standard. Dhe prej te knalla deri te lapidari është tjetër standard, edhe në Shëngjin brenda në dy-tre vende është tjetër standard. Dhe unë kam bërë letrën, jam takuar dhe me nënkryetarin e bashkisë, kam takuar dhe Paulin Dushën, e kam lënë me shpjegimet që më dhanë ata, e kam lënë me kuptimin e mirë, besimin se duhet të ketë një arsyetim njerëzor, se ne verës, më mirë të ikim diku me qera. Kam qejf që të merret parasysh dhe të verifikohet edhe njëherë nëse është mundësia.

-Pjerin Ndreu: S'ka asnjë lloj mundësie. Është kërkesë e papajtueshme për bashkinë. S'ka bazë fare. Domethënë ajo në momentin që ne kishim lënë parkingun, Nuk është shenjë ajo e nuk mund të merret prej Lapidarit e te Knalla ku është rruga 10 metra, më tepër. S'ka sens ajo punë. Domethënë ti thu gjashtë metra rrugë, t'i vëmë edhe një parking aty.

E para punës njëherë në asnjë vend të botës, mësojeni këtë edhe shkoni në gjithë botën se çfarë kërkoni në Shqipëri. Është një tjetër gjë e kur shkoni në botë rrini urtë. Në botë ka zona që ta bllokojnë komplet hyrjen e trafikut edhe në orare gjatë ditës. Zonat e plazhit e të tjera, ka parkingje private ose me parkingje që janë brenda pallateve ku banorët e pallateve mund të parkojnë me kartë rezidenti. Që këtë mund ta bëjmë ne, po jo në rrugë. Në rrugë kryesore, në asnjë vend ku bëhet turizëm, nuk mund ta konceptosh që ti të krijosh një nukël parkingu në mes rrugës. Vetëm në Shqipëri e kërkojnë.

E kam bërë me dije dje që edhe shëtitoret kryesore, të gjithë hotelëritë, do të bëhet një skaner se ku janë spotet ku mund të lejohet parkingu dhe ku është tokë shteti dhe ku është privat, sepse janë duke u aksesuar parkingjet nga privatët në tokën e shtetit dhe s'pagojnë asnjë lek. E krijojnë edhe kaos. Në lirshmërinë, në standardin e turizmit, nuk ka parkingje në mes të rrugës.

-Ndue Luli: Vazhdojmë me kërkesën e dytë. Kërkesa e dytë është e një qytetari nga Malësia e Lezhës. Banon në Itali. Ka lidhje me tokën që ka atje, por të jeni në dijeni përderisa i ka ardhur

këshillit si kërkesë, në bashkëpunim edhe me administratën e bashkisë, i është dhënë drejtorisë së aseteve për ta ndjekur këtë problem. Kështu që për sqarime të mëtejshme, mund të na thotë zv/kryetari. Bëhet fjalë për qytetarin Kol Ndrejaj.

-Fatjon Zefi: Në lidhje me kërkesën që ju ka ardhur ju, i ka ardhur edhe bashkisë, kam telefonuar vetë me zotërinë që ndodhet jashtë shtetit në lidhje me pretendimet e tij që në një tokë shtet në Velë thotë që po bëhen uzurpime, po bëhen dokumenta, falsifikime, njëra-tjetra. Zotëria nuk kishte asnjë dokument zyrtar që të vërtetojë pretendimet e tij dhe i premtova që çdo vendim, çdo dokument që do të kalojë nga drejtoria e kadastrës së bashkisë do të verifikohet dhe nuk do të ketë asnjë pajisje me dokument pronësie në mënyrë të paligjshme. Aq më tepër që atje është pyll, që nuk është arë ose çdo tjetër siç pretendonte zotëria. Drejtori do të shtojë diçka.

-Ndue Luli: Qartë. Po drejtor.

-Nikolin Shtjefni: Atëherë, rasti konkret është në lidhje me paketën e maleve, ku qytetari pretendon që mund të bëhen investime, por paketa e maleve e ka të shprehur qartë gjithë procedurën që ndiqet dhe në momentin që do vijë, do bëhet konsultim publik, në qoftë se do ketë një kërkesë mbi atë pronë, qytetari ka të gjitha të drejtat me sjellë gjithë dokumentacionin që disponon, në mënyrë që të mos procedohet më tej. Domethënë është saktësuar shumë qartë në ligj te pjesa e paketës së maleve, kjo pjesë, pra në qoftë se do ketë një aplikim mbi atë pronë, por edhe qytetari të paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor ose të thënat nga banorët që ajo pronë i përket atij, ka një dokument, ka një histori dhe domethënë është shumë e qartë kjo pjesë. Nuk ka pse të shqetësohet.

-Ndue Luli: Okej, faleminderit. Atëherë tjetër mendim kush ka? Zonja Marku.

-Alfrida Marku: Tri problematika shkurtimisht. Janë disa familje te rruga afër drejtorisë rajonale të mjedisit, të cilat para disa muajve i janë drejtuar bashkisë për hapjen e një rruge e cila ekziston në hartë. Deri më sot nuk janë marrë masa për ta zgjidhur definitivisht problemin, por kjo situatë i pengon në mënyrë të padrejtë këto familje për të aksesuar rrugën kryesore, qoftë edhe me shërbimin e ambulancës, më është referuar nga njëra prej tyre. Nga një banore e lagjes Rushman Hasani në Ishull Shëngjin, kam marrë një kërkesë dje për vendosjen e strukturave për ngadalësimin e shpejtësisë së makinave. Sipas zonjës, mjetet qarkullojnë me shpejtësi ku me të drejtë bëhen rrezik për banorët e lagjes. Edhe unë kërkoj që nga Bashkia Lezhë të merren masa jo vetëm për këtë rrugë, por edhe në rrugë të tjera ku me të vërtetë shpejtësia e mjeteve rrezikon banorët. Një tjetër problematikë dhe kërkesë është që policia bashkiake të ndërhyjë për disiplinimin e trafikut kryesisht në nyjet ku po zhvillohen punimet për infrastrukturën e kanalizimeve në qytet. Edhe këtu e kam fjalën kryesisht për zonën e xhamisë, te xhamia, ku është kthyer me një sens kalimi edhe krijon një trafik shumë të madh edhe pengim. Rinë me disa minuta të tëra makinat të bllokuara. Gjithashtu tek 11 janari, ku tashmë është bllokuar, pra po vejohet me punimet dhe është me një sens kalimi rruga, kurse tek katedralja po vjen edhe stabilizohet. E fundit që e ezaurova pak më përpara është kërkesa për të përfshirë në rend dite, kërkesën e drejtë të banorëve të lagjes Dragiaj të fshatit Kakarriq për rikthimin e emërtimit të hershëm.

-Pjerin Ndreu: E nderuar këshilltare, merr ankesën e qytetarëve për rrugën, se stafi im nuk e ka një ide se ku është dhe kontakto stafin. Jo të gjitha janë për mbledhje këshilli. E keni të drejtën,

thirrini nënkryetarët, secili prej këshilltarëve, kërkush nuk ju ndalon, që të shkoni te njëri nga strukturat e bashkisë në rolin e këshilltarit dhe të kërkoni shpjegime se është bërë një ankesë. Ajo për të cilën ne jemi duke u përplasë së brendshmi është kjo, vonesa e mosadresimit dhe ne e kemi çuar në nivelin pothuajse në kuotën optimale, por prapë ka kësi devijacionesh e gjërash që nuk kapen. E dyta, këto bumet e rrugës, ne do i shohim me një projekt që do bëjmë me plastikë, jo siç janë. Unë i kam stimuluar bizneset. Për shembull te rruga Shtraus, po bëhet biznesi, sepse ne në fakt nuk na lejohet si bashki me hy me i bë. Vetëm në shkolla. Veç njoftoni policinë në telefon edhe shkojnë ata. Megjithatë, me shtrimin e rrugëve që do bëjmë ne dhe me disa infrastruktura, ne do bëjmë një vlerësim se ku duhet të ndërhyjmë me pengesa, po plastike që janë edhe më vizive.

Për këto punimet në terren së fundmi kam filluar të dëgjoj lloj lloj përrallash. Unë mendoj se është një situatë që është e pamundur që policia bashkiake të rrijë aty. Ne do ia kërkojmë edhe ministrisë, se është agravuar pak, por pak ditë do jetë se tërhiqen firmat, se janë këto nyjet e kolektoreve ku mblidhen të gjitha bashkë. Ka dhe nga ata që thonë që kam kanalin para pallatit, pallatin tim s' e kap, po ka kolektorin poshtë. Pra është një system për të cilin të gjithë mundohen me bë si specialist. Ky është investimi më spektakolar që mund t'i ndodhë një qyteti. Dhe po ju them këtu në këshill, lançimi i Milot Balldrenit, besoj se brenda dy javëve do jetë i shpallur. Ne kemi adresuar me 116 rrugë urbane e rurale që bëjmë ne tani dhe me ujësjellësat edhe me 26 milionë euro që kemi marrë për rrjetin e shpërndarjes së ujësjellësit në Shëngjin dhe për dyfishimin e kapacitetit të ujërave të zeza mbi këtë që jemi duke bërë tashti, unë mendoj se Lezha është futur në një sistem të qëndrueshëm. Normalisht zhvillimi ka problemet e veta. Ka probleme me kanale, ka probleme me trafikun, ka probleme me kohën. Kjo kompani madje na ka krijuar disa lehtësira në mënyrën se si e ka realizuar, të jashtëzakonshme, që unë nuk e kam pritur. Unë kam pritur një kaos më të madh në qytet, por nuk ka qenë ai kaosi përtej limitit të punimeve. Dhe punimet po shkojnë duke u mbyllur tashmë. Pra do mbyllen. Unë i kam gati me e shtrë nesër rrugën. Ne s'kemi lënë gjë dhe po bëjmë edhe një projekt tjetër që të mbyllim edhe disa xhepa që na i kanë lënë kur i kanë projektuar. Po është situatë e përkohshme dhe ne duhet të flasim shqip për këtë punë. Po ju them, është e dhimbshme kur i shoh edhe ca dramatizime publike. Sinqerisht. Po unë nuk ndalem dhe bashkë duhet të bëhemi solidarë për të zhvilluar qytetin. Këtë medalje e marrim të gjithë ne që jemi këtu, që jemi në këshill. Secili e ka vënë një tullë dhe e ka vënë një dorë për ta zhvilluar këtë qytet. Cilësia e jetesës do të rritet me Milot Balldrenin. Unë e kam thënë publikisht këtë në "Opinion", nëse nuk bëhet Milot Balldreni, ai qytet me turizmin nuk bëhet.


-Ndue Luli: Faleminderit. Fjalën e ka nënkryetari i Bashkisë.

-Fatjon Zefi: Pikat 6, 7 dhe 8 të rendit të ditës u kaluan me shpejtësi ndoshta për faj të drejtorëve që nuk reagueshin. Do të ndalesha te pika 8, projektvendimi për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore, duke qenë se edhe Bashkia e ka prioritet, por edhe ka qenë shqetësimi i disa këshilltarëve shpesh për kalimin e këtyre listave. Ju kemi shpjeguar gjithmonë që jemi të varur nga ato çfarë sjell ASHK-ja. Për momentin janë 14 familje bujqësore që kalon toka nga përdorimi në pronësi, kështu që në të ardhmen ato mund të marrin edhe leje ndërtimi për shkak se zona po merr zhvillim pas ndërtimit të rrugës Rrilë-Hidrovor. Faleminderit.

-**Ndue Luli:** Faleminderit. Ka diçka tjetër? Nuk ka. Atëherë ju falenderoj për pjesëmarrjen, për mendimet dhe propozimet që patët. Mirupafshim në mbledhjen e ardhshme.

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen “Këshilli i Bashkisë Lezhë”.

SEKRETARI

Florida Çunaj


KRYETARI

NDUE LULI
